



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 52, datë 21.05.2024

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 536, DATË 1.5.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË DURRËS TË QARKUT TË DURRËSIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 23, pika 11, nenit 54, nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, nenit 3, të Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, Vendimit nr. 500, datë 14.08.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.01.2023, “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, Udhëzimit nr. 15, datë 30.06.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, VKM-së nr. 669, datë 07.8.2013, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH) si metadatë”, i ndryshuar, VKM-së nr. 782, datë 07.10.2020, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtjen e hartës kadastrale”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës për disa ndryshime në vendimin nr. 536, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës të Qarkut të Durrësit”, të ndryshuar, si më poshtë:

Miratimin e përditësimit të pronës me nr. 155, të listës së transferimit, me emërtimin Shkolla 9-vjeçare “Met Hasa”, sipas formularit të përditësimit dhe planit të rievimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dymishi



U shpall sot me datë 22.05.2024



Lidhja 1


Bashkia Durrës, Njësia Durrës

Numri rendori pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
155	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi



1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Per zyrën e pronave: Enli Kaculi (specialist) ; Anila Muhja (specialist)
 Per ASHK Durres: Gerald Kaci (specialist)
 (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
 Supervizori: Pranvera Gagani (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
 Pergj.Zyres se Pronave: Alneida Rroshi (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
 Drejtonia Ligjore
 (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
 Aprovoji: Eminiana Sako (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)
KRYETAR



Qendror Shtetror (Bashkia): Durres

Zona Kadasir. & Indeks i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronat/pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
					Truall (m2)	Ndërtesë (m2)					
1574 K-34-87-(238-B)	24/1	Truall dhe Ndertese	Shkollia Met Hasa Rajoni 4 Porto Romano Bashkia Durres	1815.2 m2	1815.2 m2	425.3 m2	Arsim Parauniversitar	Bashkia Durres	Bashkia Durres	VKM nr.538 Dt.07.08.2012	



Shënim: Spërfaqja totale do të plotësohet vetëm për pronat me shumë komponentë (që përbëhen nga disa pasuri).

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI _SHTET_

DATE 10/05/2024

QELIMI_PER PERDITESIM

VENDNDODHJA

BASHKIA DURRES

DVASHK/ZVASHK DURRES

ZONA KADASTRALE 1574

NUMRI PASURISE 24/1

INDEX HARTE K-34-87-(238 - B)

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE: NDERTESE + TRUALL

SIP.PASURISE= 2850 m2

SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= 0 m2


NUMRI KATEVE -2

NUMRI PEMEVE _____

X 451595.7845
Y 4581693.8045

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 452397.8113
Y 4581693.8045



SHPJEGUES
 ■ SIP. E TRUALLIT = 1815.2 m2 (SIPAS FAKTIT)
 ■ SIP. E NDERTESES = 425.3 m2 (SIPAS FAKTIT)

SH 1:1000

X 451595.7845
Y 4581195.9449

X 452397.8113
Y 4581195.9449

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	V			24/2		
2	J			24/3		
3	L			23/2		
4	P			25/2, 25/1, 22/4		

REALIZOI PER BASHKINE DURRES

PUNOI

ANILA MUHJA
ENLI KACULI

PERGJEGJES SEKTORI PRONAVE: PRANVERA GAGANI
NENSHKRIMI

DREJTORIA LIGJORE : ALNEIDA RROSHI
NENSHKRIMI

PER ASHK : GERALD KACI
NENSHKRIMI

KRYETAR: EMIRIANA SAKO
NENSHKRIMI

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: _KP;HK.

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

Sipas VKM-se Nr. 536, dt.01.05.2008, formularit te inventarizimit me Nr liste 155 bashkelidhur VKM-se ka kaluar nje pjese ne pronesi te Bashkise Durres te pasurise 24/1. Bashkia Durres kerkon qe te regjistroje te gjitha pasurine 24/1 ndertese + truall. Nga matjet faktike rezulton 1815.2 m2 truall dhe perkatesisht ndertim

Kati per dhe = 425.3 m2

Kati i pare = 425.3 m2

PRONARI BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

NENSHKRIMI



Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 328 / prot.
17

Durrës, më 29.05 .2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

29.05.24 N. 584/3

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.52 datë 21.05.2024 “Për miratimin e kërkesës për disa ndryshime në Vendimin Nr 536 dt 01.05.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës të Qarkut të Durrësit” te ndryshuar”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

